



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit për regjistrimin e bujqësisë Nr. 04/L -127 dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR REGJISTRIMIN E BUJQËSISË NË
KOMUNËN E LIPJANIT

Neni 1
Përbërja e Komisionit

Formohet Komisioni Komunal për regjistrimin e bujqësisë, në këtë përbërje :

- 1.Imri Ahmeti , Kryetar i Komunës
- 2 Feti Krasniqi, Drejtor i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
- 3.Avni Olluri, Drejtor i Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër
4. Hakile Xhaferi, Shefe e Divizionit të statistikave kryesore nga MBPZHR, anëtare dhe
- 5.Shkëlzen Rexhepi, Nëpunës i Zyrës Rajonale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në Prishtinë, anëtar.

Neni 2
Detyrat e Komisionit

II. Komisioni në pajtim me dispozitat e nenit 18 të Ligjit për regjistrimin e bujqësisë, do ti kryej detyrat në vijim:

- Organizon, realizon dhe kryen projektin e regjistrimit bujqësor në Komunë;
- Mbikëqyrë regjistruetit, kontrollorët dhe personelin tjetër të përfshirë në regjistrim dhe siguron funksionimin normal gjatë fazës së regjistrimit si dhe ndërhyr në rast te pengesave gjate procesit te regjistrimit;
- Azhurnon listën e ekonomive familjare bujqësore në zonat urbane dhe listën e njësive juridike;
- Ngritë vetëdijen e popullsisë dhe ekonomive familjare bujqësore për rëndësinë e regjistrimit, metodat dhe periudhën e kryerjes së tij, të drejtat dhe detyrat e pjesëmarrësve në Regjistrim dhe për mënyrën në të cilën ata duhet t'i kryejnë ato;
- Pranon materialet e regjistrimit nga kontrollorët dhe i kontrollon ato, së bashku me mbikëqyrësit;
- Merr pjesë në përgatitjen e rezultateve të para të regjistrimit për Komunën së bashku me mbikëqyrësin, në pajtim me nenin 12 të këtij ligji dhe brenda dhjetë (10) ditëve pas përfundimit të regjistrimit i'a dorëzon rezultatet e para dhe materialet e regjistrimit Agjencisë për Statistika;
- Përzgjedh numrin e regjistruetve nga lista e para-përzgjedhur dhe personelin tjetër shtesë, me qëllim që të sigurohet funksionimi normal, i saktë dhe në kohë i regjistrimit;

- Sipas udhëzimeve dhe vendimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, merr masat e nevojshme për regjistrimin, bënë përgatitjen dhe kryen Regjistrimin në tërë territorin e Komunës, ofron informata dhe ndihmon personelin e regjistrimit lidhur me vendbanimet;

- Në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës i trajnon regjistruarit dhe kontrollorët dhe mbikëqyre punën e tyre;

- Në përputhje me udhëzuesin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, i raporton rregullisht asaj lidhur me zhvillimin e procesit të regjistrimit brenda Komunës, përderisa gjatë periudhës së punës në terren për regjistrim, raporton për çdo ditë;

- Siguron lokalet, pranon dhe deponon materialet e regjistrimit në Komunë dhe i dorëzon ato Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Neni 3

Hyrja në fuqi

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe në Tabelën e Shpalljeve të Kuvendit të Komunës ndërsa me nga një kopje e këtij Vendimi do të njoftohen, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural, Agjensia statistikore e Kosovës si dhe Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 320-11246

Lipjan, më 18.03.2014

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

